

VENDIM
Nr.431, datë 27.4.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.362, DATË 1.4.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 2, e 20, të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 11 të kreut II “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”, shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Shtetasit e vendeve të përcaktuara në lidhjen nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të pajisur me vizë “Shengen”, të tipit “C”, për qëndrim afatshkurtër, dhe të tipit “D”, me shumë hyrje/dalje, si dhe me lejeqëndrimi, të lëshuar nga vendet anëtare të “Shengenit”, lejohen të hyjnë, qëndrojnë dhe tranzitojnë në Republikën e Shqipërisë brenda afatit të vlefshmërisë së vizës apo lejes së qëndrimit, pa pasur nevojë të pajisen me vizë nga autoritetet përkatëse shqiptare.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha